



BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 51, datë 11.11.2015

Për

**“NJË NDRYSHIM NË NIVELIN E PAGAVE TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË
DHE PËR KALIMIN E PUNONJËSVE TË POLICISË SË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
(ISH KOMUNAVE), POLICISË BASHKIAKE TË TIRANËS ”**

Në mbështetje të nenit 32, shkronja “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8654, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nenit 5, shkronja “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); shkronjës “d” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.518, datë 16.08.2012 “Për disa ndryshime në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, (të ndryshuar)”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.573, datë 03.07.2013 për “Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.27, datë 28.12.2011 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave të institucioneve të varësisë”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.10, datë 12.10.2011, për “Krijimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.8, datë 05.04.2012, për “Krijimin e Galerisë së Artit Bashkëkohor Tiranë “Tirana Art Gallery”; pikës 4 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11, datë 05.04.2012, për “Ristrukturimin e Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, “Qendrës komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë” dhe “Qendrës komunitare për të moshuarit”, miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”; pikës 3 të vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 60, datë 24.12.2012 për “Krijimin e qendrës komunitare Shkozë dhe miratimin e strukturës së saj organizative si dhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të strukturës organizative të qendrës sociale “Të qëndrojmë së bashku”, qendrës sociale multidisiplinare dhe qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.4, datë 01.03.2012 për “Krijimin e qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët” dhe miratimi i strukturës organizative”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë nivelin e pagës minimale për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorisë së Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorisë nr.3 të Punëtorëve të Qytetit për *klasën e I-rë*, të *II-të* dhe të *III-të* me pagë bazë 22 000 lekë.
2. Efektet financiare të pikës nr.1, fillojnë më 1 Tetor të vitit 2015 dhe përballohen nga buxheti i këtyre institucioneve për vitin 2015.
3. Të miratojë nivelin e pagës minimale për punonjësit e qendrave sociale: “Të qëndrojmë së bashku”; “Qendrës sociale multidisiplinare”, “Qendrës komunitare Shkozë” dhe “Qendrës sociale “Shtëpia e përbashkët”, për *klasën e I-rë* me pagë bazë 22 000 lekë.
4. Efektet financiare të pikës nr.3, fillojnë më 1 Tetor të vitit 2015 dhe përballohen nga buxheti i këtyre qendrave për vitin 2015.
5. Paga e grupit në Lidhjet Nr.1, Nr.5, Nr.6, Nr.7/1 dhe Nr.11 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 27, datë 28.12.2011; në Lidhjen Nr.13 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.10, datë 12.10.2011 dhe në Lidhjen Nr.14 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.8, datë 05.04.2012, për diplomat e arsimit të lartë bëhet si në tabelën më poshtë:

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10000 lekë

6. Efektet financiare të pikës nr.5 të këtij vendimi fillojnë më 1 Tetor të vitit 2015 dhe do të përballohen nga buxheti i këtyre institucioneve për vitin 2015.
7. Të ndryshojë niveli i pagave i pëcaktuar në Lidhjen nr.11 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 17.07.2009, sipas lidhjes nr.11 bashkëlidhur këtij vendimi.
8. Të miratojë kalimin e 23 punonjësve të policisë së njësive administrative (ish komunave), në Policinë Bashkiake të Tiranës.
9. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Qendrat Sociale: “Të qëndrojmë së bashku”, “Qendra sociale multidisiplinare” dhe “Qendra sociale “Shtëpia e përbashkët”, “Qendra komunitare Shkozë”, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Qendra Kulturore “Tirana”, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Klubi Sportiv “Tirana”, Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja Nr.11

Niveli i pagave për punonjësit e “Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”
(Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë Tiranë)

Nr	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
			1	2	3	
1	Kryeinspektor	II-a	1	2%	105 000	
2	Drejtor	II-b	1	2%	85 000	
3	Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%	60 000	
4	Përgjegjës sektori të zonave	III-a/1	1	2%	60 000	3 000
5	Inspektor	III-b	1/2	2%	55 000	3 000
6	Specialist I	III-b	1/2	2%	55 000	
7	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	41 000	
8	Specialist III	IV-b	1/2/3	2%	31 000	
9	Specialist me arsim të mesëm	IV-c	4	2%	30 000	2 000
10	Punonjës mbështetës, shofer				34 000	
11	Pastrues				30 000	

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr. 11 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë